

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Lipjanit Opština Lipjan – Municipality of Lipjan	
---	---	---

Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Dhe Dhuna Ndaj Grave

(2024-2026)

Komuna Lipjan

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje



Kontaktet:

Policia e Kosovës – Lipjan – 038-581-010, 0800 1 9999 dhe 192

Qendra për Punë Sociale – Lipjan - Telefoni kujdestar – 044 187 235

Thirrjet emergjente - 112

Zyra për Ndihmë dhe Mbrojtje Viktimave - 0800 11112

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – 0800 11 777

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve – 038 545 476, 044 420 052

Falenderim

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e Mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje, për hartimin e Planit të Veprimit Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave, nën koordinimin e zyrtarës nga QPS me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjerë të partnerëve

Plani Lokal i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Lipjanit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Përmbajtja

Hyrje përmbledhëse

Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit

Plani i Veprimit

Plani i monitorimit dhe raportimit

Hyrje përmbledhëse

Dhuna në familje është vepër penale¹ dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës² në kuadër të parimeve të saj, mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

¹ Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore në familje, që “dhunën në familje”³ e përkufizon: “veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën”. Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjimore (2022 – 2026), që një herrit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal,

Duke dënuar të gjitha format⁴ e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*”⁵, plani i veprimit është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit⁶ (i datës 15 prill 2019), karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësi që rrjedhin nga marrëveshja e mirëkuptimit . kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Në të njëjtën kohë, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqërorë ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

³ Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezë, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare: <http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf> 2;

⁴ Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

⁵ OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

⁶ Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funksionimit të të tij , në Komunën e Lipjanit më datë 05.02.2016 me nr.prot.1Nr.560-6061/1;

II Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut⁷ dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave⁸ dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më e madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje,

Para së gjithash, plani do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Plani lokal i veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Lipjanit, synon të:

- ☐ Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- ☐ Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- ☐ Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- ☐ Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si “*Vetëdijësimi dhe Parandalimi*”; “*Mbrojtja dhe Koordinimi*”; “*Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi*” me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

⁷ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994; <https://ëëë.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

⁸ Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

Objektiva Strategjike #1: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike #1.1: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Objektiva specifike #1.2: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

Objektiva Strategjike # 2: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje:

Objektiva specifike # 2.1: Funksionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

Objektiva specifike # 2.2: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.3: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike # 2.4: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në Familje;

Objektiva Strategjike # 3: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje:

Objektiva specifike # 3.1: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje;

Objektiva specifike #3.2: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në Familje;

Plani i Veprimit 2024-2026

Nr.	Objektivat specifike, veprimet	strategjike dhe treguesit dhe		Vlera bazë	Objektivi përkohshëm [2024]	i vitit të fundit [2025]	Rezultati				
I.		Objektivi strategjik: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje									
	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet			Vlera Bazë	Synimi 2025	Synimi 2026					
1	Treguesi: % e mekanizmave institucional kanë njohurit e duhura për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje			30 %	50 %	70 %	Promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave dhe marrja e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje				
2	Treguesi: % e popullsisë kanë njohurit e duhura për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje			25%	35%	50%	Qytetarët e Komunës ____ kanë njohurit e duhura për rolin dhe përgjegjësin qytetare për mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut dhe parandalim të dhunës në familje				
I.1		Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje									
1	Treguesi: Nr. i profesionistëve kanë njohurit e duhura për standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës në familje			30 %	50 %	70%	Parimet dhe standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës në familje janë pjesë integrale në përditshmërinë e mekanizmave relevant				
2	Treguesi: Nr. i profesionistëve kanë njohurit e duhura për obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore vendore për parandalim dhe luftim të dhunës në familje			30%	50%	70%	Prioritizimi dhe rritja e efikasitetit të trajtimit të rasteve për parandalim dhe luftim të dhunës në familje				
Nr.	Veprimi			Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca dokumente në
					2024	2025	2026				

I.1.1	Realizimi i sesioneve informuese për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, ngritja e kapaciteteve të profesionistëve institucional për Konventën e Këshillit të Europës; Ligjin kundër dhunës në familje; bashkërendimin e rasteve për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje	2024 -2025			1000 euro	1000 euro	1000 euro	Komuna Donatorët	Komuna ZBGJ, PK, QPS, MV, ZDJF,	-2 takime me përfaqësuesit institucional te nivelit lokal kanë njohurit e duhura për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; - 2 takimme profesionistët institucional te stacionit policor kanë njohurit e duhura për Konventën e Këshillit; - 1 takim; Profesionistët institucional të drejtorisë se arsimit kanë njohurit e duhura për Ligjin kundër dhunës në familje; -5 sesione informuese brenda vitit për bashkërendimit të rasteve	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë; Konventën e Këshillit të Europës; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;
-------	---	------------	--	--	--------------	--------------	--------------	---------------------	--	---	--

I.1.2	Punësimi i më shumë i psikologëve/pedagogëve në çdo shkollë	2024-2026		Target 2024 / 26			Komuna	Komuna DKA	Në vitin 2026 do të përfshihen edhe 5 psikolog/e shkollore.	Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;
I.1.3	Ngritja e njohurive të mësimdhënësve në identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në familje	2024-2026		3000 euro (OJQ SIT)	1000 euro (OJQ SIT)		Komuna Donatorët/ OJQ SIT(pjesë e grupit)	Komuna DKA	150 mësimdhënës/e për periudhën 2024/2026 - Mekanizmat e shkollës kanë njohurit e duhura për parandalimin, identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe dhunës në familje;	Ligji për Arsimin Parauniversitar; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026;
I.1.4	Vizitë studimore lidhur me funksionimin e mekanizmit koordinues në trajtimin të rasteve të dhunës në familje	2024-2026		Vizitë studin ore jashtë vendit			Komuna Donatorët	Komuna	Rritja e njohurive mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas standardeve ndërkombëtare;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
I.1.5	Ngritja e njohurive të policisë në trajtimin miqësor të viktimave në momentin e raportimit	2024-2026		Sesion trajtnues			Komuna Donatorët	Komuna	Rritja e njohurive mbi përgjigjen adekuate në rastet e raportimit të dhunës në familje sipas standardeve ndërkombëtare dhe	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore;

									rritjen e besimit te viktimave	
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.1:									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
I.2	Objektivi specifik: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje									
1	Treguesi: % e qytetarëve kanë njohurit e duhura për përgjegjësitë qytetare për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje;		20%	40%	60%	Familja është institucion ku të gjithë anëtarët janë të sigurt, jetojnë në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi që nxitë barazinë në mesin e anëtarëve të saj.				
2	Treguesi: % e qytetarëve që kanë përfituar nga aktivitetet vetëdijësuese për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje					Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për t'i thënë ndal dhunës në familje				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca dokumente në
				2024	2025	2026				

I.2.1	Organizimi i fushatës vetëdijësuese për të drejtat e njeriut me fokus të drejtat e grave; Fushatë vetëdijësuese lidhur me manifestimet e formave të dhunës në familje, pasojat e saj dhe nevojën për të parandaluar dhunën; Shtypja dhe shpërndarja e “Konventës të Stambollit”	2024-2026		1000	1000	1000	Komuna Donator ët /OJQ SIT	Komuna ZBGJ	Rritja e njohurive të qytetarëve për të drejtat e njeriut dhe drejtat e grave; Rritja e ndërgjegjësimit dhe perceptimit nga publiku i gjerë lidhur me format e dhunës; Mekanizmat përgjegjës institucional njohin masat e vëna në dispozicion të “Konventës të Stambollit”	Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi; Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;
I.2.2	Realizimi i sesioneve informuese me fëmijë dhe të rinj për rolin dhe përgjegjësit e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës.	2024/2026		1 sesio; Asambleja e fëmijëve	1 sesio; Asambleja e fëmijëve	1 sesio; Asambleja e fëmijëve	Komuna Donator ët	Komuna ZBGJ	Fëmijët dhe të rinjtë kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, MV, ZNJF, strehimoret)	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
I.2.3	Realizimi i sesioneve informuese me gra dhe viktimat të dhunës në familje për rolin dhe përgjegjësit e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës.	2024/2026					Komuna Donator ët	Komuna ZBGJ	10 sesione në strehimore me Gratë dhe viktimat e dhunës në familje, kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, MV, ZNJF, strehimoret)	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
I.2.4	Organizimi i aktiviteteve jo-formale (përmes artit, eseve, ekspozitave, dramave, etj) me	2024/2026		1000 euro	1000 euro	1000 euro	Komuna Donator ët	Komuna ZBGJ	DKA informate metutje! Rritja e vetëdijësimit të shoqërisë për të mos	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës

	fokus parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.								pranuar dhe për të mos toleruar pabarazitë dhe dhunën në familje;	kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plan Strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026;
I.2.5	Informimi i publikut përmes rrjeteve sociale për mbrojtjen që iu ofrohet viktimave të dhunës në familje dhe institucionet përkatëse ku duhet të orientohen	2024/2026					Komuna Donator ët	Komuna ZBGJ	KP- me perdore vetem nje platforme; Opinioni publik ka njohurin e duhur për ekzistencën dhe rolin e shërbimeve për mbrojtje nga dhuna në familje	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.2:</i>									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet		Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2026]	Rezultati				
II.		Objektivi strategjik: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje								
1	Treguesi: Komuna ka zhvilluar politika lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje		1	5	7	Parandalimi dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje janë vendosur në agjendën e prioriteteve të qeverisjes lokale				
II.1		Objektivi specifik: Funksionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje								
1	Treguesi: Nr. i takimeve të realizuara nga Mekanizmi		6	6	6	Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i fuqizuar sipas TOR				

	Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje									
2	Treguesi: Nr. i aktiviteteve të realizuara nga Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje		5	4		12	Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2026	2026				
II.1.1	Hartimi i Rregullores së Punës të Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje	2024					Komuna Bashkepunetore e jashtem	Komuna Koordinatore DNJ-BGJ	Rregullorja e Punës e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, e aprovuar	Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;
II.1.2	Hartimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për mbrojtje nga dhuna në familje; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale lidhur me marrjen e masave për parandalim, trajtimin, strehimin dhe mbrojtje të dhunës në familje; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale	2024-2026					Komuna Bashkepunetore e jashtem	Komuna Koordinatore DNJ-BGJ	Raporti i monitorimit për mbrojtje nga dhuna në familje i hartuar nga Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Rritja e koordinimit institucional	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;

	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik II.1:									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
II.2		Objektivi specifik: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje								
1	Treguesi: Nr. i rasteve të raportimit të dhunës në familje		X	X	X	X	Qytetarët janë inkurajuar të raportojnë rastet e dhunës në familje në institucionet përkatëse			
2	Treguesi: Nr. i ankesave të parashtruara nga viktimat e dhunës në familje		X	X	X	X	Viktimat e dhunës në familje përdorin shërbimet e specializuara			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2025	2026				
II.2.1	Identifikimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave në terren	2024/2026					Komuna	Komuna	Rritja e numrit të rasteve të identifikuar në terren nga mekanizmat relevantë;	Ligji për familjen; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Ligji për Policinë;
II.2.2	Vizualizimi i shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas	2024/2026					Komuna Donatorët	ZNJF	Rritja e vizibilitetit të mandatit dhe shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas	Ligji për Ndihmë Juridike falas
II.2.3	Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse	2024/2026					Institucionet e mekanizmit			

II.2.4	Numri i rasteve të dhunës në familje me vendim përfundimtar gjykate	2024/2026					Gjykata			
II.3	Objektivi specifik: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje									
1	Treguesi: treguesit për mbrojtjen nga dhuna në familje		Treguesit e identifikuar	Treguesit e përfshirë në bazë të dhënave		Baza e të dhënave funksionale	Integrimi i sistemit lokal për mbrojtje nga dhuna në familje			
2	Treguesi: raporti i monitorimit i publikuar					Raporti vjetor	Vlerësimi i progresit të zbatimit të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje			
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2025	2026				
II.3.1	Grumbullimi i të dhënave të standardizuara mbi dhunën në familje; Përcaktimi i nevojave, sfidave, përparësive dhe marrja e masave në bazë të analizës së të dhënave për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; Hartimi i raportit vjetor për mbrojtje nga dhuna në familje; Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore	2024-2026					Komuna Donatorët	Komuna	Komuna në vazhdimësi gjeneron të dhëna për mbrojtje nga dhuna në familje; Orienton politikat dhe veprimet institucionale bazuar në të dhëna cilësore; Raporti vjetor mbi situatën për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, i publikuar; Zyrtarët institucional kanë njohurit e duhura për mbledhjen,	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Marrëveshja e Mirëkuptimit për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;

									përdorimin dhe analizimin e të dhënave;	
II.3.2	Mbështetje logjistike për Policinë në trajtimin të rasteve të dhunës në familje për transportim dhe qasje në shërbime emergjente.	2024-2026					Donator ët	Komuna dhe Policia e Kosovës	Mundësohet transportimi për viktimat në qasje për shërbime emergjente qofshin ato mjekësore, paraqitje në gjykatë apo shërbime tjera mbështetëse.	
II.4		Objektivi specifik: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në familje								
1	Treguesi: Nr. i viktimave të dhunës në familje të punësuar		X	X		x			Janë fuqizuar ekonomisht viktimat e dhunës në familje	
2	Treguesi: Nr. i politikave komunale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të aprovuara		X	X		X			Komuna ka marrë të gjitha masat administrative afirmative për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje	
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2024	2025				
II.4.1	Referimi i rasteve për ngritje profesionale në qendrat e aftësimi profesional për viktimat e dhunës në familje	2025					Komuna APRK Donator ët	Komuna	Viktimat e dhunës në familje, profilizohen me profesione të caktuara	Strategjia Kombëtare për Zhvillim; Programi i Kosovës për barazi Gjinore 2020-2024; Objektiva 5 për Zhvillim të Qëndrueshëm

II.4.2	Subvencionimi/përkrhja e projekteve për rehabilitim dhe riintergrim të viktimave të dhunës në familje; Ndërmjetësimi për punësim për viktimat e dhunës në familje	2024 - 2026					Komuna Donatorët	Komuna; Zyra e punësimit	10projektet zhvillimore/ biznesore të viktimave të dhunës në familje, të subvencionohen nga Komuna dhe ojç; Rritja e numrit të viktimave të dhunës në familje që janë punësuar	Strategjia Kombëtare për Zhvillim; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Objektiva 5 për Zhvillim të Qëndrueshëm
Nr.	Objektivat strategjike dhe treguesit dhe veprimet		Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2026]	Rezultati				
III.	Objektivi strategjik: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje									
1	Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese për viktimat e dhunës në familje		X	X	X	Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve rehabilituese për viktimat e dhunës në familje;				
2	Treguesi: Nr. i shërbimeve riintegruese për viktimat dhunë në familje		X	X	X	Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve riintegruese për viktimat e dhunës në familje;				
III.1	Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje									
1	Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese të qasshme		X	X	X	Është lehtësuar qasja në shërbime rehabilituese, efikase dhe të qëndrueshme, për viktimat e dhunës në familje;				
2	Treguesi: % e bugjetit në dispozicion për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje		X	X	X	Komuna alokon buxhet të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje;				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti				Produkti (Output)		

				2024	2025	2026	Burimi i financi mit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetë s		Referenca dokumente në
III.1. 1	Ofrimi i strehimit social për viktimat e dhunës në familje	2026		3000	3000	3000	Komuna Donator ët	Komuna	Viktimave të dhunës në familje iu ofrohet strehim;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;
III.1. 2	Ndarja e buxhetit për ofrimin e shërbimeve emergjente për viktimat e dhunës në familje	2024/2026		1000	1000	1000	Komuna Donator ët	Komuna	Shërbimet emergjente të buxjetuara dhe në dispozicion 24/7 për viktimat e dhunës në familje;	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
III.1. 4	Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje	2024/2026		1000	1000	1000	Komuna Donator ët ANJF	Komuna OJQ	QPS: Viktimave dhe kryerësit e dhunës në familje iu ofrohen shërbime profesionale psiko-sociale	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
III.1. 5	Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe këshilluese për ruajtjen e	2024/2025					Komuna Donator ët	Komuna	Viktimave të dhunës në familje iu ofrohen shërbime profesionale	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës

	shëndetit mendore për viktimat e dhunës në familje						QSHM QMF		për ruajtjen e shëndetit mendor	kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.1:									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									
III.2		Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në familje								
1	Treguesi: Nr. i viktimave të dhunës në familje të punësuar		X	X	X			Fuqizimi i viktimave të dhunës në familje për jetesë të pavarur		
2	Treguesi: Nr. i viktimave të dhunës në familje përfitues të subvencioneve nga komuna		X	X	X			Fuqizimi i viktimave të dhunës në familje për jetesë të pavarur		
Nr.	Veprimi	Afati i fundit		Buxheti			Burimi i financimit	Institucion i udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
				2024	2025	2026				
III.2.1	Vlerësimi i nevojave të viktimave të dhunës në familje	2024/2025					Komuna Donatorët	Komuna	Viktimave të dhunës në familje, iu ofrohet përkrahja e nevojshme sipas nevojave të identifikuar	Konventa e Stambollit; Ligji kundër dhunës në familje;
III.2.2	Sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje	2024/2025					Komuna Donatorët DMS	Komuna	120 mbrenda vitit; viktimave të dhunës në	Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës

									familje iu ofrohet strehim i sigurte	kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.2:</i>									
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>									
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>									

Plani i monitorimit dhe raportimit

Synimi kryesorë i Komunës së Lipjanit pa dyshim se është realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit e planit në baza vjetore.

Koordinatorë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muaj do të raportojë direkt Kryetarit të Komunës.

Me ç ‘rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë “Raportin e Monitorimit” mbi zbatimin, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.